



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË
KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA SOCIALDEMOKRATE,
PJESËTARE E KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE", PËR ZGJEDHJET
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për pranimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Lushnje, Kamëz, Tiranë, Elbasan të paraqitura nga Partia SocialDemokrate, pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1 dhe pika 2, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia SocialDemokrate, si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia SocialDemokrate, me vendimin e KQZ-së nr. 139, datë 09.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e



Nr. 644 i Vendimit

Data 23.05.2019

Ora 14:30 e Vendimit

Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "SocialDemokrate", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

KQZ-së nr.251, datë 7.05.2019, është regjistruar koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", pjesë e të cilit është dhe Partia SocialDemokrate.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Lushnje, Kamëz, Tiranë, Elbasan. Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetarë apo për këshillin e bashkive: Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Lushnje, Kamëz, Tiranë, Elbasan; pasi bashkitë Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Lushnje, Kamëz, Tiranë, Elbasan administrohen nga më shumë se një KZAZ.

KQZ, ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkive:

- Shkodër me vendimin nr. 427, datë 16.05.2019.
- Korçë me vendimin nr. 466, datë 17.05.2019.
- Kamëz me vendimin nr. 465 datë 17.05.2019.
- Tiranë me vendimin nr. 533 datë 18.05.2019

Brenda afatit Partia SocialDemokrate ka plotësuar dokumentacionin sipas vendimeve të KQZ-së për Bashkinë, Shkodër, Korçë, Kamëz, Tiranë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetarë apo për këshillin e bashkive: Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Lushnje, Kamëz, Tiranë, Elbasan pasi këto bashki administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Lushnje, Kamëz, Tiranë, Elbasan;
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtar këshilli në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Lushnje, Kamëz, Tiranë, Elbasan të propozuar nga Partia SocialDemokrate;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë;
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit;

Në mbledhjen e datës 23.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive: Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Lushnje, Kamëz, Tiranë, Elbasan të Partisë SocialDemokrate dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" përveç se:



Nr. 644 i Vendimit

Data 23.05.2019

Ora 14:30 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "SocialDemokrate", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

1. **Z. Ardian Luigj Marku**, kandidat për anëtar në **Këshillin e Bashkisë Lezhë**:
 - me vendimin nr. 182 datë 01.12.2006, është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprën penale parashikuar nga neni 174 K.P "Kontrabandë me mallrat e tjerë", ndaj të cilit është vendosur masa e dënimit 200.000 lekë gjobë;
 - me vendimin nr. 129 datë 24.11.2003, është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprën penale parashikuar nga neni 278/2 K.P "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake", ndaj të cilit është vendosur masa e dënimit 6 (gjashtë) muaj me burgim;
 - **Në pikën 5** ka deklaruar se është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprën penale parashikuar nga neni 278/2 K.P "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake", ndaj të cilit është vendosur masa e dënimit 6 (gjashtë) muaj me burgim.

2. **Z. Erin Pjetër Gjoni**, kandidat për anëtar në **Këshillin e Bashkisë Lezhë**: Me vendimin nr. 74 datë 01.03.2010 është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprën penale parashikuar nga neni 186/1 dhe 291 K.P, ndaj të cilit është vendosur masa e dënimit 2 vite e 2 muaj provë.
 - Me vendimin nr. 345 datë 27.09.2011 është dënuar nga Gjykata ALBA, Itali, për veprën penale parashikuar nga neni 582 dhe 585 K.P, ndaj të cilit është vendosur masa e dënimit 5 vite e 3 muaj pezullim.
 - Me vendimin nr. 263 datë 09.12.2017 është dënuar nga Prokuroria e Herceg Novi, për veprën penale parashikuar nga neni 412 dhe __ K.P, ndaj të cilit është vendosur masa e dënimit 350€ gjobë.
 - Në datë 20.10.2009 është ndaluar nga prokuroria Shkodër për arsye " Patent fallco", për të cilën është gjykuar.
 - Në datë 19.07.2011 është ndaluar nga Prokuroria ALBA Itali për arsye "Konflikt të çastit" , për të cilën është gjykuar.
 - Në datën 09.12.2017 është ndaluar nga Prokuroria Hercegov Novi, Mal i Zi për arsye "Pashaportë të dëmtuar", për të cilën ka paguar gjobë.

Në pikën 4 të formularit ka deklaruar se është ndaluar nga Policia Portuale Greqi periudha mes 2011-2013, për arsye "Dyshim për emigracion të paligjshëm", për të cilën nuk është dënuar.

Në pikën 5 të formularit të vetëdeklarimit ka deklaruar Masa shtrenguese " Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore". Është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në bazë të nenit 186/1 dhe 291 të K.P, vendimi përfundimtar shuarje mase, datë 20.10.2009.

3. **Z. Sentiljan Goga**, kandidat për anëtar në **Këshillin e Bashkisë Fier**: ka deklaruar vendimin e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Vlorë, (me kusht).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga ku rezulton se:

Lista shumemërore e Bashkisë Lezhë:

1. Kandidati me numër **rendor 1, z. Ardian Luigj Marku** në bazë të vendimit nr.129 dt.24.11.2003 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e ka deklaruar fajtor për veprën penale: Armëmbajtje pa leje të armëve luftarake parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal është dënuar me(6) gjashtë muaj burgim. Në zbatim të nenit 406 te Kodit të Pr.P. është dënuar me 4 muaj burgim. Gjykata e Apeli Shkodër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.129 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Rehabilituar në bazë te nenit 69/a të Kodit Penal.



Nr. 644 i Vendimit

Data 23.05.2019

Ora 14:30 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "SocialDemokrate", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të vendimit nr.182 dt.01.12.2006 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e ka deklaruar fajtor për veprën penale të: Kontrabandës me mallra të tjera, paradhikuar nga neni 174 i Kodit Penal, është dënuar me 200 000 Lekë Gjobë. Përdorimit të dokumentave të falsifikuara parashikuar nga neni 186/1 kodit Penal, është dënuar me 100 000 Lekë Gjobë. Në aplikim të neneve 55 të Kodi Penal dhe nenit 406 të K.Pr.Penale është dënuar me 133 333 Lekë Gjobë. Rehabilituar në bazë të nenit 69/a të Kodit Penal.

2. Kandidati me numër **rendor 3, z. Bledar Mark Deda** në bazë të Vendimit nr.486 datë 23.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është deklaruar fajtor për veprën penale "Drejtim të automjetit" në mënyrë të parregullt. Në zbatim të nenit 406 të K.P është dënuar me 20 ditë burgim. Në zbatim të nenit 53 të K.P. është pezulluar ekzekutimi i vendimit me burgim dhe është zëvendësuar me 100 000 Lekë Gjobë. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.
3. Kandidati me numër **rendor 5, z. Erin Pjetër Gjoni** në bazë të vendimit nr.74 dt.01.03.2010 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e ka deklaruar fajtor për veprën penale: të "Falsifikimit të dokumentave" parashikuar nga neni 186/1 kodit Penal, është dënuar me 3 muaj burgim dhe me 200 000 Lekë gjobë, për veprën penale "Drejtim automjeti pa dëshmi" parashikuar nga neni 291 i K.Penal dhe është dënuar me 50 000 leke gjobë. Në aplikim të nenit 55 të Kodi Penal dhe nenit 406 të K.Pr.Penale është dënuar me 2 muaj burgim , me 140 000 Lekë gjobë dhe vënien në prove për një periudhë dy vjacare të mbaje kontakte me Shërbimin e proves. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Lista shumemërore e Bashkisë Fier:

1. Kandidati me numër **rendor 5, z. Enver Avni Hajdini** në bazë të vendimit nr. 214, dt.10.10.1978 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është deklaruar fajtor për veprën penale "Plagosje e lehtë me dashje" të parashikuar nga neni 93 të Kodit Penal është dënuar me 6 muaj riedukim nëpërmjet punës. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.
2. Kandidati me numër **rendor 9, z. Sentiljan Goga** në bazë të vendimit nr. 258, dt.22.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është deklaruar fajtor për veprën penale "Vjedhje e mbetur në tentativë" të parashikuar nga neni 134/1 të Kodit Penal është dënuar me 3 muaj burgim. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Lista shumemërore e Bashkisë Korçë:

1. Kandidati me numër **rendor 7, z. Jeton Aleksandi Llazari** në bazë të vendimit nr. 529 datë 17.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është deklaruar fajtor për veprën penale të "Vrasje nga Pakujdesia" dhe në bazë të nenit 85 të K.Penal si dhe në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Pr.P është dënuar me 8 muaj burgim. Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 129 datë 09.07.2012 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit me këtë plotësim në bazë të nenit 59 të K.Penal urdhërohet ; Pezullimi i ekzekutimit të dënimit për një periudhë kohe prej tre vjet. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Lista shumemërore e Bashkisë Vlorë:

1. Kandidati me numër **rendor 9, z. Shkëlqim Shyqo Llanaj** në bazë të vendimit nr. 414, dt.13.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është deklaruar fajtor për veprën penale "Ndërtim i paligjshëm dhe shpërdorim toke" të parashikuar nga neni 199/a/1, 199, 55 të Kodit Penal është dënuar me 100 000 lekë gjobë. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.



Zyra e gjendjes gjyqësore nuk ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, të Bashkisë Lushnje. KQZ do të vazhdojë e procedurat të mëtejshme për verifikim.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumëmemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 dhe pika 2 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkive: Lezhë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Lushnje, Kamëz, Tiranë, Elbasan të Partisë SocialDemokrate, pjesëtare të Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 644 i Vendimit

Data 23.05.2019

Ora 14:30 e Vendimit

Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "SocialDemokrate", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019